

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

I

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

"WOODSAL" Shpk

KREU I

Emri, forma, selia, kohëzgjatja

Neni 1

Data e themelimit dhe Emri

Me efekt nga data 14/02/2025 themelohet shoqëria "WOODSAL". Shpk

- 1.1 WOODSAL SHPK, (në vijim "Shoqëria") e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", i cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortaket e Shoqërisë ("Ortaket") gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e Shoqërisë të përfaqësuar në kuota.
- 1.3 Në të gjithë dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të leshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj dëhet ndiqet ose dëhet shoqërohet nga:
 - 1.3.1 Fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "Shpk"
 - 1.3.2 Numri Unik i Identifikimit të Subjektit NUIS
 - 1.3.3 Adresa e regjistruar
 - 1.3.4 Pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedurë likuidimi, në qoftëse ky rast paraqitet.
 - 1.3.5 Kapitalin e regjistruar të Shoqërisë dhe kapitalin e paguar të Shoqërisë

Neni 2

Forma Ligjore

- 2.1 Shoqëria është një entitet Shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në përputhje me ligjin Nr.9910, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji i Shoqërive").



Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqerisë ndodhet ne adresen: Vaqarr, Tirane, regjistruar ne ASHK Tirane me Nr.Pasurie 291/44, Zona Kadastrale 3712, Kod Unik 3712013014, Tiranë, Shqipëri. Shoqeria ka të drejtë të ndryshoje selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqeria mund te hape degë të saj ose zyra perfaqesimi brenda dhe/ose jashte territorit te Republikës se Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e Shoqerisë është e pacaktuar.

KREU II

Neni 5

Objekti i shoqerise

- 5.1 Objekti aktivitet i Shoqerisë dote jete te kryej çdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanerisht sa meposhte:

- Prodhim dhe perpunim lende drusore. Ndertime te ndryshme me lende druri, Konsulence profesionale per mbeshtetje teknike per ndertimin e objekteve te drurit.

Veprimtari tregtimi me shumice dhe pakice ne fushen e mobiljeve, import-eksport dhe sherbime te lidhur me to dhe arredime, projektme, interior, per ambiente te ndryshme, konkretisht import - export materiale druri te perpunuara dhe te paperpunuara, import -eksport materiale ndihmese ,lende e pare dhe aksesore per prodhimin mobiljeve. Realizimi i kerkesave te klienteve sipas modeleve dhe materialet e kerkuara. Ofrimin e sherbimit te montimit dhe transportit te mobiljeve te shitura nga shoqeria sipas kerkeses se klienteve te saj, si dhe cdo lloj aktiviteti i lejuar nga legjislacioni Shqiptar ne Fuqi

Per te arritur qellimin e Shoqerisë, shoqeria mund te:

- Shoqëria mund të kryejë çdo veprim mbi tituj, pasuri te paluajtshme, produktivitet, transaksione tregtare dhe financiare qe organi administrativ i konsideron te domosdoshem dhe/ose të dobishëm për të.



2



Neni 6

Ndryshime

6.1 Shoqëria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

KREU III

Kapitali Themeltar, Kuotat e kapitalit Themeltar

Neni 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali i Shoqerisë është i shprehur ne kapital në para, në vleren 120.000 Lek që do të perdoren si kapital i Shoqerisë plotesisht të nënshkruara dhe të pashlyera.

Ky kapital është i barabarte me 3 (tre) Kuota. Kontributet mund te bëhen ne natyre dhe në vlerë monetare, ne perputhje me ligjin.

7.3 Kapitali i Shoqerisë do të shlyhet nga Ortakët, në proporcion me pjeset e tyre takuese.

Neni 8


Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat

8.1. Ortaket e Shoqerisë dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte:

Nensi Shyti, lindur me 18/07/1988 shtetas Shqiptar, i biri i Shefqet, me nr. letërnjoftim 039299522 dhe nr. personal I80718067S, i lindur në Elbasan, Shqipëri dhe banues në Tiranë, me zotesi te plote per te vepruar, zoteron nje kuote që perfaqeson 33.4 % të kapitalit të Shoqerisë.

Aldi Rusi, lindur me 10/07/1988 shtetas Shqiptar, i biri i Beniamin, me nr. letërnjoftim 033227741 dhe nr. personal I80710080F, i lindur në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, me zotesi te plote per te vepruar, zoteron nje kuote që perfaqeson 33.3 % të kapitalit të Shoqerisë

Ilir Kola, lindur me 03/10/1984 shtetas Shqiptar, i biri i Stavri, me nr. letërnjoftim 034091355 dhe nr. personal I41003027B, i lindur në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, me zotesi te plote per te vepruar, zoteron nje kuote që perfaqeson 33.3 % të kapitalit të Shoqerisë



Neni 9

Zvogëlimi dhe zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Asamblese së përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me Kreun IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të Shoqërive.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
- 9.3 Rritja e kapitalit dote bëhet me kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
- 9.4 Zmadhimi i kapitalit nuk dote dobesojë pjesën e interesit të Ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë, përveçse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vendim i cili merret me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ e votave.
- 9.5 Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuota të saj. Megjithatë me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortaket mund të autorizojnë Administratorin/Administratoret të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesë të tyre dhe ti anullojnë ato.

Neni 10

Te drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

- 10.1 Ortaket janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuotat e Shoqërisë.
- 10.2 Çdo Ortak do të ketë të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve ("Asambleja e Përgjithshme") në përputhje me vlerën nominale të kuotës që zotëron. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të shpërndajë fitimet, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, për çdo marrëveshje të detyrueshme ndërmjet Ortakëve dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Shoqërive.
- 10.3 Ortakëve do t'u jepen, me kërkesë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.
- 10.4 Te drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek çdo zotërues i ri për këto Kuota.
- 10.5 Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë. Ortakët nuk mbajnë

pergjegjesi që tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerisë (përvec garancive dhe huave që ata realizojne).

10.6 Shoqeria nuk mban pergjegjësi për borxhe ose detyrime te tjera të Ortakeve të saj.

Neni 11

Transferimi i pjesëve të Kapitalit

11.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.

11.2 Në rast se një Ortak do të shesë, transferojë, ose përdore në mënyra të ndryshme pjesë apo të gjithë kuotën e tij Ortaku tjetër do të ketë të drejtën e parablerjes, kundrejt blerësve të tjerë.

Nese Ortaku me të drejtë parablerjeje do të ketë bërë një ofertë dhe kjo oferte është refuzuar nga Ortaku që shet, atëherë Ortaku tjetër do të rishikojë oferten e bërë dhe do t'i bejë Ortakut që shet një ofertë të dytë. Nese edhe kjo ofertë e dytë është refuzuar nga Ortaku që shet, atëhere ky i fundit (Ortaku që shet) nuk do të ketë të drejtë të shesë kuotën tek një blerës tjetër me cmim me të ulët se çmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar në ofertën e dytë.

11.3 Çdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqerive dhe duhet të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12

Kompetencat

12.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi drejtues i Shoqerisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

Neni 13

Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme

13.1 Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet te pakten i herë në vit.

5

13.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.

13.3 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në menyrë tjetër aktive, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 20% e të gjithë aseteve të Shoqërisë, sic rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bazën e raportit të ekspertit kontabel të autorizuar, që do t'i paraqitet Asamblesë, përveç rastit kur kjo blerje bëhet në Bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.

13.4 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një Ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 20% e aseteve të Shoqërisë, sic rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

13.5 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 13.3 dhe 13.4, Asambleja e Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, përveç rastit kur kjo blerje bëhet në Bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.

13.6 Ortaket do të organizojnë takime me Administratorët të paktën një herë në vit me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së kryera nga Administratorët, diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet që janë objekt i aprovimit nga ana e tyre, përfshirë çështjet për të cilat Administratorët nuk bien dakord.

13.7 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolute këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 14

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjeve

14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e shtrëna përpara saj nëpërmjet thirrjes së mbledhjeve ose nëpërmjet konsultave me shkrim.

14.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga një prej Administratorëve ose nga cilido prej Ortakëve.

14.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e Shoqërisë, në Shqipëri apo në çdo qytet siç dakordësohet midis Ortakëve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e kësaj takime si dhe rendi i ditës përkatës i mbledhjeve u njoftohet Ortakëve me postë të regjistruar të paktën 7 ditë para mbledhjes. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, kjo e fundit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë Ortakët bien dakord.




- 14.4 Secili prej Ortakeve gëzon të drejtën të përfaqesohet nga një person tjetër në perputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërive.
- 14.5 Secili prej Ortakeve ka të drejtën të votojë në perputhje me kuotën e zotëruar prej tij në kapital.
- 14.6 Vendimet e mëposhtme do të miratohen me miratimin e Ortakeve që zotërojnë të paktën 75% të kapitalit të Shoqërisë:
- (i) Pagesa e çdo dividendi në kesh apo natyre Ortakeve të Shoqërisë;
 - (ii) Nenshkrimi i marrëveshjeve financiare në lidhje me Shoqërinë apo nxjerrja e instrumentave të borxhit nga Shoqëria;
 - (iii) Blerja e çfarëdoqësojë kuote apo interesi tjetër në çdo biznes dhe sipërmarrje;
 - (iv) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë siç është përcaktuar në Nenin 9 të këtij akti;
 - (v) Ndryshime dhe amendime të këtij Akti Themelimi; dhe
 - (vi) Likuidimi apo shpërndarja e Shoqërisë.
- 14.8 Ateherë kur ligji e kërkon këtë, rezolutat e Ortakeve duhet të noterizohen nga një noter publik Shqiptar. Në rast se këto rezoluta miratohen jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet t'i nënshtrohen kërkesave të ligjit Shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Republikën e Shqipërisë (dmth duhet t'i nënshtrohen procedurës së superlegalizimit ose apostillimit, në varësi të vendit ku leshohen).
- 14.9 Ortaket do të njoftohen për Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve dhe përmbajtjen e axhendës së takimit.
- 14.10 Administratoret duhet të mbajnë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve, në perputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit të Shoqërive.

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes

- 15.1 Një ortak përjashtohet nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- (i) Vlerësimin e veprimtarisë së këtij Ortaku.
 - (ii) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
 - (iii) Ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria.



(iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V

Administratoret

Neni 16

Administratori dhe kompetencat

16.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administratoret mund te jene te çdo kombësie dhe nuk eshte e nevojshme të jenë rezidentë në Shqiperi.

16.2 Nensi Shyti lindur me 18/07/1988 shtetas Shqiptar i biri i Shefqet me nr. letërnjoftimi 039299522 dhe nr. personal I80718067S, lindur në Elbasan, Shqipëri dhe banues ne Tiranë ne adresën: Tish Daija; Nd. 4; H. 1; Ap. 31; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, me zotesi te plote per te vepruar, do të jëtë Administrator i Shoqerisë.

16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, me të drejte rinovimi kontrate për periudhe të ngjashme kohore, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendrës Kombetare te Biznesit), me te drejtë ripërteritje të ketij mandati.

16.4 Menjëherë pas pranimi të emerimit të tij/tyre, Administratori(et) njohin nese marrëdhënia e tyre me Shoqerinë ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me këtë vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje mbledhje të Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.


16.5 Ortaket kane te drejtën të shkarkojne Adminsitratoret më shumice të thjeshte votash.

16.6 Nese Administratoret e Shoqerisë nuk arrijne te bien në nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, ceshtja do të referohet tek Ortakët.

16.7 Per aq sa është e lejueshme dhe në perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht prezent në Shqiperi ose në ambjentet e Shoqerisë.

Neni 17

Kompetencat dhe detyrimet



8

- 17.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerisë perfshijne:
- i. Thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e specifikuara ne nenin 13.
 - ii. Menaxhimin e aktivitetit tregtar te Shoqerisë nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
 - iii. Perfaqesimin e Shoqerisë.
 - iv. Kujdesin për mbajtjen në menyre të përshtatshme të dokumentave dhe librave kontabël të Shoqerisë.
 - v. Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblesë se Përgjithshme.
 - vi. Kryejne regjistrimet dhe dergojnë të dhenat e Shoqerisë pranë Qendres Kombetare te Biznesit, kur është e nevojshme.
 - vii. Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rendesi të veçantë për veprimtarine e Shoqerisë.
 - viii. Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortakët.
- 17.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne që zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerisë te veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqerisë.

Neni 18

Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

18.1 Përvec sa është parashikuar në dispozitat e Përgjithshme te detyrimit te besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 të Ligjit të Shoqerive,

Administratoret detyrohen:

- i. Te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerisë ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerisë ne mjedis;
- ii. te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- iii. te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- iv. te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerisë;
- v. te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

18.2 Administratoret gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen kundrejt Shoqerisë per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerisë, me perjashtim

te rasteve kur, ne haze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

18.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

18.4 Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundërshtim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:

- i. I kthen Ortakeve kontributet;
- ii. I paguan ortakeve interesa apo dividente;
- iii. I shperndan asete Shoqerise;
- iv. lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj, kur duhet te kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk dote kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj.
- v. jep hua.

KREU VI

Auditimi Financiar i Shoqerise .

Neni 19

Eksperti Kontabel i Autorizuar

19.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per te audituar Shoqerine.

19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

Aktiviteti Shoqerise

Neni 20

Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31- te te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 21

Mbaitia e Llogarive

21.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe në monedhe të huaj.

Neni 22

Llogaritja dhe Shperndaria e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqerisë percaktohet ne bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpendarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Nga fitimet vjetore, do të caktohet nje fond rezervë ne perputhje me kushtet e Legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

22.3. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shpemdaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shpendarje:

- I. Asetet e Shoqerisë mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
- II. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.

22.4. Administratoret lëshojnë nje certifikate të aftesisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpendarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerisë tregon se shpendarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kriteret, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

22.5. Administratoret pergjigjen ndaj Shoqerisë per vertetesine e certifikates se aftesisë paguese.

KREU VIII

Modifikimi i Formes Ligjore. Prishja

Neni 23

Modifikimi i Formes Ligjore

23.1 Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

Neni 24

Prishja e Shoqërisë

24.1 Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:

- (i) si pasojë e perfundimit të kohëzgjatjes për të cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- (iii) hapje e një procedure falimentimi;
- (iv) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykatë;
- (vi) për arsye të tjera të parashikuara nga Ortaket në çdo kohë;

24.2 Administratori(et) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendres Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723 datë 3.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit". Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykatë, kjo e fundit, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit", ia njofton vendimin Q.K.R-së për regjistrim.

KREU IX

Të ndryshme

Neni 25

Largimi i ortakut

25.1 Largimi dhe përjashtimi i një Ortaku, si dhe pasojat që kjo sjell, do të rregullohen nga nenet 101, 102, 103 të Ligjit të Shoqërive.

12

Neni 26

Te tjera

26.1. Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

26.2 Përpilimi i këtij dokumenti është në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje origjinale e saj ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.


Nenshkrimi i Themeluesve/Ortakeve

WOODSAL Shpk

NENSI SHYTI

ALDI RUSI

ILIR KOLA

Nensi Shyti


Aldi Rusi


Ilir Kola
